

PËRDOR OTURAKUN



Së shpejti mund të shkoj në kopësht : a duhet të jem i mësuar të shkoj në WC (të rri pa pamper)?



Kur (nga cila moshë) duhet të filloj të ushtrohem të përdor oturakun)?

Mami! : Si t'ia bëjmë për t'u mësuar të shkoj në WC (të përdor oturakun)?

A e mësoj unë këtë në shkollë? Apo në shtëpi?

Kur të fillosh me stërvitjen për të shkuar në WC/oturak?

Kur fëmija yt ...

- është e gatshme fizikisht
- e dallon ndjenjën kur i vjen për të urinuar
- thotë vetë që është e gatshme të përdorë oturakun
- bezdiset nga duqet (pampersi) i lagur
- qëndron i thatë (nuk urinon në mbathje/duqe) për një kohë më të gjatë
- tregon kureshtje në WC dhe se çfarë bëhet (ndodh) aty
- shkon e fshihet kur don të urinojë
- thotë/tregon që ka urinuar, p.sh. : duke e vënë dorën mbi duqe (pamper)
- ...

Disa këshilla :

- Mësoje fëmijën tënde me oturakun : lëre p. sh. : të luajë me të.
- Mundohu t'a vësh fëmijën tënde në oturak në momentin kur zakonisht urinon në duqe. Kështu ju krijoni një rregjim të rregullt.
- Është e rëndësishme që t'a shpërbleni/qerasni fëmijën tuaj nëse ajo bën diçka në oturak, sado pak që të jetë.
- Mos u inatos nëse edhe pas disa herësh nuk ka bërë gjë në oturak.
- Në pjesën e pasme të kësaj flete mund të gjeni **një plan me hapa** për t'u marrë me këtë çështje.

*Një fëmijë mund të mësohet të shkojë në WC **që rreth moshës 2 vjeç**. Nëse fëmija juaj fillon kopështin por nuk është mësuar plotësisht të shkojë në WC, atëherë kjo mund të arrihet nëse punohet hap pas hapi **bashkë me shkollën**.
SHKOLLA NUK MUND T'A BËJË VETËM!*

PLANI ME HAPA



- hapi 1**
- Nuk ka gjë që, fëmijët e kopështit bëjnë më me shumë qef, sesa imitimi.
 - Merre fëmijën tënde me vete kur ti vetë, kur vëllai ose motra duhet të shkoni në WC.
 - Kështu ajo/ai do të kuptojë më mirë se çfarë është (për çfarë shërben) oturaku.
- hapi 2**
- Mësoje fëmijën tënde me oturakun.
 - Lëre të luajë me të.
 - Shpjegoja se për çfarë shërben oturaku.
- hapi 3**
- Mos e vër (mos e lër) fëmijën tënde tepër gjatë në oturak.
 - Vëre atë në oturak në orare të caktuara (jo pa rregull).
 - Për shembull : çdo herë pasi të hajë.
- hapi 4**
- Sado pak që fëmija juaj të bëjë në oturak shpërblejeni/qeraseni atë!
 - Mundohuni të rrini të qetë nëse nuk ka bërë gjë në oturak.
 - Mos u inatos nëse nuk mësohet shpejt, por jepi kurajo fëmijës tënde.
- hapi 5**
- Në pranverë ose në verë është ideale (më e përshtatshme) për të filluar me stërvitjen për t'u mësuar për të shkuar në WC.
 - Ti mund t'a lësh fëmijën tënde të rrijë e luajë zhveshur (pa mbathje).
 - Fëmija jote e kupton më mirë nëse në atë rast ndodh ndonjë gjë.



Për t'a mësuar fëmijën tuaj të shkojë në WC është e rëndësishme që shkolla dhe familja të bashkëpunojnë!

Lexo edhe këshillat në librin 'het ABC van baby tot kleuter' të Kind&Gezin !

Si e vë re që fëmija jote është e gatshme për këtë?

Shumica e fëmijëve mësohen të shkojnë në WC mes moshës 2 deri 4 vjeç. Jo çdo fëmijë është gati për këtë në të njëjtin moment. Prandaj mos i bëni presion fëmijës (mos e detyroni). Pritni disa javë dhe pastaj provojeni edhe një herë.

Fëmija jote jua bën vetë të ditur se kur është e gatshme të ulet në oturak.

Këtë e dalloni nga këto gjëra :

- Qëndron i thatë (nuk urinon në mbathje/duqe) për një kohë më të gjatë.
- Fëmija jote tregon kureshtje kur të tjerët shkojnë në WC.
- Ajo/ai shkon e fshihet kur don të urinojë.